

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Sabri Rrapi,	Anëtar i “ “
Zija Vuci,	Anëtar i “ “
Hajredin Fuga,	Anëtar i “ “
Alfred Karamuço,	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi,	Anëtar i “ “
Kujtim Puto,	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi,	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, më datë 10.05.2000, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.30 Akti që i përket:

KËRKUES: Një grup deputetësh të Kuvendit të Shqipërisë, përfaqësuar nga Spartak Braho.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në mungesë.
2. Këshilli i Ministrave, në mungesë.

O B J E K T I

Interpretimi i nenit 103/3 të Kushtetutës së Shqipërisë

Një grup prej 36 deputetësh të kuvendit të shqipërisë, me cilësinë e subjektit që vë në lëvizje një gjykim kushtetues, të cilët përbëjnë jo më pak se një të pestën e deputetëve, i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese për të interpretuar nenin 103/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, lidhur me pozitën juridike që duhet të kenë anëtarët e Këshillit të Ministrave të cilët nuk janë deputetë të Kuvendit, për sa i përket imunitetit si dhe përcaktimit të organit që jep autorizimin për fillimin e çështjes penale ndaj tyre.

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi përfaqësuesin e kërkuarve dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

Neni 103/3 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se anëtarët e Këshillit të Ministrave gëzojnë imunitetin e deputetit. Kjo dispozitë e Kushtetutës i jep anëtarëve të Këshillit të Ministrave në saj të funksionit të tyre të rëndësishëm shtetëror një mbrojtje të veçantë ligjore. Duke e bazuar mbrojtjen ligjore të anëtarit të Këshillit të Ministrave me atë të deputetit, Kushtetuta i ka dhënë të njëjtin kuptim juridik imunitetit për këtë kategori funksionarësh.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, megjithëse i njeh anëtarit të Këshillit të Ministrave imunitetin, nuk përcakton me saktësi procedurën që duhet ndjekur dhe organin, i cili ka të drejtë të vendos në rastet e heqjes së imunitetit dhe dhënien e autorizimit për fillimin e ndjekjes penale të këtyre funksionarëve.

Prandaj, për kërkuarësin del e domosdoshme interpretimi i nenit 103/3 të Kushtetutës dhe përcaktimi i procedurës dhe organit kompetent, që vendos për heqjen e imunitetit dhe dhënien e autorizimit për fillimin e ndjekjes penale të anëtarit të Këshillit të Ministrave, i cili nuk është deputet.

Për të interpretuar dispozitën e mësipërme, Gjykata Kushtetuese nisët nga rregullimi konkret që parashikon neni 103/3 duke ju referuar nenit 73 dhe në tërësi konceptit, që Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka përcaktuar për imunitetin e funksionarëve të lartë të shtetit.

Në disa dispozita të Kushtetutës jepet vetëm e drejta e gëzimit të imunitetit për një pjesë të

funksionarëve të lartë të shtetit, por nuk parashikohet procedura që duhet ndjekur për heqjen e imunitetit. Janë ligjet përkatëse ato që parashikojnë dhe rregullojnë në mënyrë më të hollësishme këtë moment juridik. Rregulli i referimit të gëzimit të imunitetit për një pjesë funksionarësh të lartë është parashikuar në disa dispozita të Kushtetutës si në nenin 61/3, 154/5 dhe 165/2 të saj. Nga e njëjta referencë ligjore nuk bën përjashtim as anëtari i Këshillit të Ministrave, i cili sipas nenit 103/3 gëzon imunitetin e deputetit.

Meqenëse vetë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e barazon në aspektin substancial gëzimin e imunitetit të anëtarit të Këshillit të Ministrave me imunitetin e deputetit, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin, se edhe procedura që ndiqet për heqjen e imunitetit të deputetit, e parashikuar në nenin 73 të saj dhe në nenin 173 e vijues të Rregullores së Kuvendit do të jetë e zbatueshme dhe për anëtarin e Këshillit të Ministrave që nuk është deputet.

Në kuptim dhe zbatim të dispozitave të sipërcituara Gjykata Kushtetuese konkludon, se dhënia e autorizimit për fillimin e ndjekjes penale për anëtarin e Këshillit të Ministrave që nuk është i zgjedhur deputet, do të bëhet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë sipas procedurës ligjore që parashikohet edhe për heqjen e imunitetit të deputetit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë duke u bazuar në nenin 124 dhe 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe në nenet 71,72 dhe 79 të Ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë“, njëzëri,

V E N D O S I:

Për dhënien e autorizimit për fillimin e ndjekjes penale ndaj anëtarit të Këshillit të Ministrave, i cili nuk është i zgjedhur deputet, do të zbatohet e njëjta procedurë që parashikohet edhe për deputetin.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe ka fuqi prapavepruese.

Tiranë, më 23.06.2000
Nr.30 i Regj Themeltar.
Nr.38 i Vendimit